



# PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE PËRFSHIRJA DIGJITALE NË KOSOVË

Korrik 2025

## Gjendja aktuale në Kosovë

Përfshirja digjitale është bërë gjithnjë e më e rëndësishme në agjendën politike të Kosovës, që reflektohet në mënyrë të veçantë në Agjendën Digjitale të Kosovës 2030 dhe në Strategjinë e Qeverisjes Elektronike (2023-2027). Këto politika theksojnë zhvillimin e infrastrukturës, digjitalizimin e shërbimeve publike dhe përmirësimin e aftësive digjitale të popullsisë së përgjithshme. Megjithatë, pavarësisht përafrimit të pjesshëm me Acquis të BE-së në sektorin e telekomunikacionit, ende mbeten boshllëqe kritike, veçanërisht në adresimin e aftësive digjitale për grupet e cenueshme. Politikat e përfshirjes digjitale përqendrohen kryesisht në zhvillimin e gjerë të infrastrukturës me masa të kufizuara që synojnë për të siguruar qasje dhe përdorim të barabartë për grupet e marginalizuara.

## Treguesit bazik

Grupet e cenueshme dhe shkaqet e përjashtimit digjital

	<b>Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian</b> (aftësi të kufizuara digjitale, mungesë infrastrukture)
	<b>Individët e moshuar (65 + vjeç)</b> (shkallë e ulët të aftësive digjitale, vështirësi në përdorimin e platformave digjitale)
	<b>Personat me aftësi të kufizuara</b> (mungesë e shërbimeve digjitale të qasshme, kosto e lartë e teknologjisë ndihmëse)
	<b>Popullsia në zonat rurale</b> (qasje e kufizuar në internet të qëndrueshëm me brez të gjerë dhe në mjete moderne digjitale)
	<b>Grupet në gjendje të pafavorshme socioekonomike</b> (pamundësi për të përballuar koston e pajisjeve dhe internetit, nivel i ulët i aftësive digjitale)



## Sfidat kryesore

**Hendeku digjital:** Disparitet i theksuar ndërmjet infrastrukturës digjitale në zonat urbane dhe ato rurale.

**Nivele të ulëta të aftësive digjitale:** Hendeku i gjerë në aftësitë digjitale që prek veçanërisht të moshuarit, grupet me arsimim të ulët dhe grupet e marginalizuara.

**Fokus i kufizuar në grupet e cenueshme:** Strategjive kombëtare u mungojnë masa specifike që synojnë përfshirjen digjitale të grupeve të cenueshme.

**Zbatim dhe koordinim i dobët:** Bashkëpunim i kufizuar ndërsektorial ndërmjet institucioneve publike dhe ndaje e paqartë e përgjegjësi.

**Ekosistemi i pazhvilluar i edukimit digjital:** Investime të pamjaftueshme në infrastrukturën digjitalë dhe në ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve.

## Rekomandimet:

- Integrimi sistematik i edukimit digjital në arsim:** Përfshirja e edukimit digjital në kurrikula dhe në mësimin gjatë gjithë jetës, duke e theksuar trajnimin e mësimdhënësve për përdorimin praktik të mjeteve digjitale në klasë, për të plotësuar boshllëqet ekzistuese në aftësi.
- Përmirësimi i qasjes në shërbimet e qeverisjes elektronike:** Miratimi i standardeve të unifikuara të qasjes dhe ndërfaqe të thjeshtësuara dhe miqësore për pajisjet mobile, duke mbështetur veçanërisht përdoruesit e moshuar, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet me nivel të ulët të aftësive.
- Zgjerimi i pikave të qasjes digjitale të komunitetit:** Ngritja ose përmirësimi i qendrave digjitale të komunitetit dhe laboratorëve të TIK-ut në shkolla me staf të dedikuar mbështetës, duke ndihmuar qytetarët që nuk kanë pajisje digjitale personale dhe lidhje të internetit.
- Institucionalizimi i vlerësimeve të rregullta të përfshirjes digjitale:** Kryerja e vlerësimeve periodike kombëtare të qasjes digjitale, aftësive dhe përdorimit, të ndara sipas të dhënave demografike, për të mundësuar hartimin e politikave të bazuara në prova dhe për të rritur llogaridhënien.
- Promovimi i partneriteteve ndërsektoriale për përfshirjen digjitale:** Nxitja e projekteve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile, duke krijuar zgjidhje të shkallëzuar dhe inovative për përfshirjen digjitale përmes infrastrukturës së përbashkët dhe kornizave rregullatore të përcaktuara qartë.
- Dhënia e subvencioneve të synuara për lidhjen dhe pajisjet digjitale:** Zbatimi i skemave të ndihmës financiare për të ndihmuar familjet e marginalizuara të përballojnë lidhjen e internetit dhe pajisjet digjitale, duke zvogëluar kështu pabarazitë digjitale.
- Integrimi i kritereve të qasjes në prokurimin publik:** Bërja e detyrueshme e zbatimit të standardeve për qasje dhe përdorimpër të gjitha zgjidhjet dhe platformat e TIK-ut të prokuruar nga institucionet publike, të mbështetura me auditime të rregullta.
- Mbështetja e programeve të përfshirjes digjitale të udhëhequra nga OSHC-të:** Ofrimi i mbështetjes së qëndrueshme financiare dhe institucionale për organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë trajnime të përshtatura për aftësitë digjitale dhe që përmirësojnë qasjen në shërbime për komunitetet e cënueshme.

## Shembull i politikës premtuese: Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE)

**PËRSHKRIMI:** Projekti i Ekonomisë Digjitale të Kosovës (KODE), i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë (2019–2024) me mbështetjen e Bankës Botërore, kishte për qëllim uljen e pabarazive digjitale duke zgjeruar lidhjen me internet me brez të gjerë, veçanërisht në zonat rurale dhe të pambuluara, dhe duke përmirësuar aftësitë digjitale përmes trajnimeve të synuara.

<https://kodeproject.org/>

## Veprimet kryesore:

- Shtirja e infrastrukturës së internetit me brez të gjerë në 203 fshatra.
- Lidhje më të mirë të brendshme digjitale në 197 shkolla fillore dhe të mesme.
- Krijimi i Rrjetit të Kosovës për Hulimtim dhe Edukim (KREN).
- Ofrimi i trajnimit për aftësi digjitale për 2,190 të rinj, duke theksuar mundësitë e punësimit dhe punës online, përfshirë edhe përfshirjen e synuar të grave (881 pjesëmarrëse femra).

**Organet zbatuese:** Ministria e Ekonomisë, e mbështetur nga Banka Botërore.

**Ndikimi:** KODE përmirësoi ndjeshëm qasjen digjitale në komunitetet rurale, ngushtoi zbrazëtirat në infrastrukturë dhe u ofroi të rinjve aftësi themelore digjitale, duke rritur mundësitë e tyre për punësim. Ai demonstron se si investimet e fokusuara dhe bashkëpunimi ndërsektorial mund të adresojnë në mënyrë efektive sfidat kryesore të përfshirjes digjitale dhe të shërbejnë si një model i shkallëzuar për transformim më të gjerë digjital në Kosovë.

